



ENERGJIA DRITARE E ARDHMËRISË



DONATORËT



QEVERIA E KOSOVËS



AGJENCIA AMERIKANE PËR
ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR
(USAID)

KFW



BANKA GJERMANE PËR ZHVILLIM
(KfW)

BASHKËPUNËTORËT



AGJENCIA SUEDEZE PËR ZHVILLIM DHE
BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR (SIDA)



**MILLENNIUM
FOUNDATION
KOSOVO**

FONDACIONI KOSOVAR I MILENIUMIT (MFK)



THE WORLD BANK
IBRD • IDA | WORLD BANK GROUP

BANKA BOTËRORE (BB)



Financimi përfiton nga mbështetja e Bashkimit Evropian në kuadër të Fondit për Garantimin e Kredive të Krizës sipas Rregullores (EU) Nr 1287/2013 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për krijimin e Programit për Konkurrencë dhe Ndërmarrje dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME) (2014 -2020).



FONDI EVROPIAN I INVESTIMEVE (EIF)

INSTITUCIONET FINANCIARE PARTNERE



Të nderuar lexues,

Kemi kënaqësinë që të prezantojmë edicionin e katërt të buletinit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë! Buletini ka një mision të thjeshtë – të informojë publikun për punën, iniciativat dhe aktivitetet tona. Ky edicion i është dedikuar një teme shumë të rëndësishme në ekonominë e Kosovës, Energjinë dhe e kemi titulluar “Energjia – Dritare e ardhmërisë”.

Duke konsideruar rëndësinë si dhe duke e ndërlidhur me lansimin e Dritares së re garantuese, që Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë, me ndihmën e KfW – Banka Gjermane për zhvillim dhe në bashkëpunim me MFK do ta lansojnë duke e pilotuar me njërin nga institucionet e regjistruara financiare – ProCredit Bank.

Në këtë edicion sjellim artikuj nga akterët kyç që çojnë përpara implementimin e risive për sektorin e energjisë. Gjithashtu, në këtë edicion janë përfshirë seri aktivitetesh të zhvilluara nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë deri në fund të muajit prill 2022, si: trajnime, ligjerata në institucione arsimore të Kosovës, marrëveshesh me partnerë, prezencë në media, si dhe shumë aktivitete tjera.

Lexim të këndshëm!

PËRMBAJTJA

- | | | | |
|----|--|----|---|
| 04 | Dritarja e Rimëkëmbjes së Gjëlber (GROW) | 22 | Mbahet tryeza virtuale - “Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike - Rezultati dhe Impakti” |
| 06 | OPINIONE
Banka ProCredit në Kosovë - një shtytës i financimit të gjëlber dhe tranzicionit të energjisë në vend | 22 | FKGK mban punëtorinë “Agro Workshop” |
| 12 | OPINIONE
Energjia Efiçiente si një Domosdoshmëri në Kosovë | 23 | Lansohet fushata dhe video për Start Up-ët |
| 16 | OPINIONE
Vlerësimi i potencialit të kulmeve për solare në Kosovë | 23 | FKGK mban ligjeratën me titull “Roli i skemave garantuese” në RIT Kosovo |
| 18 | STORIE SUKSESI
METAL IN - Panelet solare - Investim i mençur | 23 | FKGK mban ligjeratën me titull “Roli i skemave garantuese” në kolegjin RIINVEST |
| 20 | KËNDI I LAJMEVE 2022 | 24 | FKGK mban trajnim me stafin e AFK-së |
| 20 | Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë nënshkruan marrëveshje me AFK | 24 | FKGK në punëtorinë “Key Account Management” të organizuar nga OEGJK |
| 20 | Të arriturat nga pako e rimëkëmbjes ekonomike | 25 | FKGK mban ligjeratën “Roli i skemave garantuese” në UBT |
| | | 25 | FKGK mban ligjeratën “Roli i skemave garantuese” në AAB |

Opinionet, mendimet dhe analizat e shprehura përmes artikujve të botuar nuk reflektojnë domosdoshmërisht qëndrimet e FKGK-së apo qasjen e Institucionit ndaj të njejtave.

DRITARJA E RIMËKËMBJES SË GJELBËR- GROW

Mirë se vini në numrin e katërt të buletinit të FKGK-së. Ky edicion i dedikohet në tërësi Energjisë si një nga çështjet strategjike për ekonominë e Kosovës, ndërsa mbështetja e investimeve të gjelbra që rrisin efikasitetin e shfrytëzimit të energjisë dhe gjenerimin nga burimet e ripërtëritshme nga Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM-të), do të jetë një nga orientimet kryesore strategjike të institucionit tonë në periudhën afat-mesme. Çuditërisht, lansimi i këtij numri të revistës së FKGK-së, përkon me lansimin e Dritares së Rimëkëmbjes së Gjelbër (GROW), dritare kjo e mundësuar nga bashkëpunimi dhe mbështetja e përbashkët në mes të MCC/MFK dhe KfW në njërën anë, si dhe FKGK-së në anën tjetër. Përmes garantimit kreditor të investimeve të gjelbra, qëllimi i dritares do të jetë promovimi i punësimit nga NMVM-të, dhe përmirësimi i konkurrencës dhe produktivitetit të NMVM-ve në mënyrë të qëndrueshme. Si rrjedhojë, të kontribuojnë në rimëkëmbjen ekonomike

të ekonomisë nacionale, pas krizës nga pandemia, përmes investimeve të gjelbra.

Kjo dritare garantuese, do të përmirësojë kushtet e financimit, në mënyrë që të rritet kredidhënia, e që do të nxisë rritjen ekonomike, zvogëlojë varshmërinë nga burimet fosile, si dhe të promovojë ruajtjen e energjisë. Kreditimi i mbështetur nga garancionet kreditore brenda Dritares GROW, mendojmë që do të arrijë të mobilizojë investime shumë të nevojshme në gjenerimin e energjisë fotovoltaike për vetkonsum për NMVM-të, duke investuar në projekte/pajisje që rrisin efikasitetin e energjisë. Lufta në Ukrainë ka shkaktuar lëkundje në tregje dhe ngritje të çmimeve të energjisë elektrike dhe të gazit natyror. Kosova, meqë burim kryesor e ka linjtitin, po ashtu është ndikuar nga këto çmime, sidomos në stinën e dimrit kur konsumi është më i lartë dhe detyrohet të importojë energji elektrike nga vendet tjera. Për ndërmarrjet kosovare, furnizimi i sigurt dhe i besueshëm me energji është



thelbësor për të siguruar qëndrueshmëri dhe konsistencë në ofrimin e shërbimeve dhe produkteve në treg, e që më pastaj kjo do t'i sigurojë rritje, dhe pse jo, edhe depërtim në tregjet rajonale. Si një kandidat potencial për anëtarësim në BE, nevoja për energji të sigurtë dhe të qëndrueshme në Kosovë është edhe më e theksuar. Prandaj dhe u propozua dritarja e re e energjisë – GROW. Implementimi i kësaj dritareje do të bëhet në disa faza:

- Faza e pilotimit do të fillojë me njërën nga institucionet financiare në muajin qershor 2022;
- Implementimi i plotë i dritares së energjisë pritet të ndodhë gjatë pjesës së dytë të vitit me të gjitha institucionet e regjistruara financiare.

Përveç skemës garantuese kjo dritare do të ketë edhe komponenten e asistencës teknike me qëllim rritjen e kapaciteteve të institucioneve të regjistruara financiare duke ofruar trajnime të përshtatura për stafin, që të orientojnë klientët drejt investimeve të gjelbra.

VLERA E SHTUAR

Zhvillimi i investimeve të gjelbra do të mundësojë promovimin e punësimit, produktivitetin dhe konkurrueshmërinë e qëndrueshme të NMVM-ve në Kosovë. Nga kjo Dritare, parashihen të përfitojnë rreth 605 NMVM dhe të krijohen mbi 1,600 vende të reja të punës. Duke garantuar këto investime, FKGK së bashku me NMVM-të do të kontribuojnë në zvogëlimin e emetimit të dioksid karbonit (CO₂). Gjithashtu, ky investim do t'i ndihmojë bankat të cilat ende nuk kanë produkte që lidhen me komponentën e kredidhënies së gjelbër, të promovojnë investimet e këtij lloji. Gjatë periudhës post-pandemike, disponimi i investimeve të bizneseve private ka ndryshuar dhe anon kah investimet që adresojnë nevojat urgjente dhe ato afatshkurtëra. Si rezultat, kemi zvogëlim të interesimit të bizneseve që të investojnë në projekte të qëndrueshme, që sjellin benefite më të ngadalshme por afatgjata për to. Bazuar në këtë propozim, me mbështetjen e dhënë me kapital nga Banka Gjermane për Zhvillim – KfW si dhe asistencës teknike nga marrëveshja



Zhvillimi i investimeve të gjelbra do të mundësojë promovimin e punësimit, produktivitetin dhe konkurrueshmërinë e qëndrueshme të NMVM-ve në Kosovë. Nga kjo Dritare, parashihen të përfitojnë rreth 605 NMVM dhe të krijohen mbi 1,600 vende të reja të punës.

e grantit për komponentën e dytë: Covid 19 – Rimëkëmbja e gjelbër - mes KfW dhe FKGK-së, u propozua që të mbështesë financimin e projekteve të NMVM-ve në efikasitet të energjisë, burimeve efikente dhe energjisë së ripërtëritshme. Kjo u bë me qëllim të promovimit të punësimit për NMVM-të në Kosovë duke përmirësuar produktivitetin dhe konkurrueshmërinë e qëndrueshme, përmes "Rimëkëmbjes së gjelbër" nga pandemia.

MFK/MCC ka mbështetur aktivitetet e FKGK-së, që të ndërtojë një plan biznesi në mënyrë të pavarur si institucion, të dizajnojë projeksione financiare, të konsolidojë burimet e nevojshme për aprovim të bordit të FKGK-së, dhe pastaj të lansojë Dritaren e Gjelbër të Rimëkëmbjes – GROW, të shoqëruar me plan komunikimi që përbëhet nga shumë aktivitete, përmes të cilave synohet që të dërgohen informata stafit të institucioneve financiare, përfituesve dhe publikut në përgjithësi. Ne si FKGK do të implementojmë dritaren ashtu si është dizajnuar me qëllim që të arrijmë synimin dhe misionin tonë si institucion, e që është kontributi aftatgjatë në energji të gjelbër.



FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

BANKA PROCREDIT NË KOSOVË NJË SHTYTËS I FINANCIMIT TË GJELBËR DHE TRANZICIONIT TË ENERGJISË NË VEND

Është e ditur që ndryshimet klimatike, mbrojtja e ambientit, tranzicioni i energjisë dhe dekarbonizimi, vitet e fundit kanë dominuar të gjithë kryetitujt, si në sektorin publik ashtu edhe atë privat. Muajt e fundit, ky zë i fuqishëm u bë edhe më i zëshëm që nga paraqitja e pandemisë dhe sulmi i Rusisë ndaj Ukrainës, pra lufta në Ukrainë.

Në gjithë këtë ambient kompleks, Kosova ka një 'miks' të energjisë më të ndotur në Europë, ballafaqohet me mungesë të furnizimit me energji, përderisa përjeton nevojë për rritje të konsumit të energjisë. Një hap i logjikshëm do të ishte që Kosova të përshpejtojë tranzicionin e energjisë drejt burimeve fleksibile dhe më të gjelbra, në mënyrë që të arrihet një e ardhme drejt një ekonomie më të gjelbër që nuk emeton dioksid karboni 'neto-zero'.

Fatkeqësisht, është jashtëzakonisht e dukshme që tranzicioni energjetik sapo ka filluar të marrë formë në Kosovë. Si do të lëvizë ky tranzicion është ende e paqartë, por pavarësisht nga forma, një gjë është e qartë: do të kërkojë kapital, financim, stimuj dhe njohuri. Roli i sektorit financiar në mbështetjen e këtij tranzicioni është thelbësor për alokimin e kapitalit për projekte më të qëndrueshme. Nuk mund të kishte moment më të mirë se tani, për të treguar historinë e Bankës ProCredit si bankë lidere dhe me përvojën më të gjatë në Kosovë, në shtyrjen përpara të agjendës së qëndrueshmërisë dhe financimeve të gjelbra.

Përderisa, identiteti i bankës ProCredit zhvillohet ndërmjet bankingut të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm, qasja e saj ndaj financimit të gjelbër inkorporon realitetin e Kosovës, si vend i vonuar në agjendën e tranzicionit të gjelbër dhe dekarbonizimit, duke bartur barrën e një



ERIOLA BIBOLLI

Drejtoreshë Gjenerale e
ProCredit Bank në Kosovë

'miksi' energjetik të varur nga karburantet fosile. Ky përfaqëson një potencial të madh të pashfrytëzuar dhe një nga sfidat më kritike infrastrukturore me të cilat përballet vendi.



Një hap i logjikshëm do të ishte që Kosova të përshpejtojë tranzicionin e energjisë drejt burimeve fleksibile dhe më të gjelbra, në mënyrë që të arrihet një e ardhme drejt një ekonomie më të gjelbër që nuk emeton dioksid karboni 'neto-zero'.

Shumë më lehtë do të ishte të themi që Banka ProCredit është e përkushtuar në adresimin e ndryshimeve klimatike si dhe financimin e qëndrueshëm dhe të gjelbër. Deri sot, jemi të vetëdijshëm që kjo nuk mjafton.

Për shumë institucione, kjo është ende një rrugë shumë e gjatë që të kalojnë nga slloganet që të tërheqin vëmendjen dhe promovimet shumë sipërfaqësore të bankimit të qëndrueshëm, deri në marrjen e hapave konkret dhe arritjen e ndikimit të drejtpërdrejtë.

Pse ndodh kështu? Për bankën ProCredit, rreshtimi drejt financimit të qëndrueshëm dhe drejtimi i bankës me përgjegjësi, nuk ka qenë gjithmonë i lehtë dhe as i thjeshtë. Është një rrugëtim që kërkon të bësh zgjedhje dhe të vendosësh prioritetet e duhura që shpesh janë në konflikt me njëra tjetrën. Kjo shpesh nënkupton, të heqësh dorë nga fitimi, duke refuzuar klientë që kryejnë aktivitete jo miqësore për ambientin, të tilla si plastika një-përdorimëshe, ose vendimi për të mos financuar projekte në zona të mbrojtura, ndërkohë që të gjithë të tjerët në sektorin bankar vazhdojnë të injorojnë standarde të tilla të gjelbra, dhe të maksimizojnë fitimet për afate shumë të shkurtëra, me një kosto të lartë degradimi mjedisor për periudha afatmesme dhe afatgjata.

Me shumë krenari mund ta them që për bankën ProCredit fjalët përkojnë me veprimet dhe jemi zotuar që vërtetë të kemi ndikim në këtë aspekt dhe jemi faktor kyq dhe një hap para në gjithë rrugëtimin e Kosovës drejt tranzicionit të gjelbër.

ProCredit në Kosovë nuk është fillestare në financimin e gjelbër dhe atë të qëndrueshëm. Ne, jemi përfshirë në financim të gjelbër për më shumë se 18 vite, qysh nga viti 2006. Si banka më e madhe në Kosovë për segmentin e NMVM-ve, kemi vepruar sipas rolit që ia kemi dhënë vetes, dhe jemi shndërruar në pararendës që ta dërgojmë vendin në drejtim të rritjes së qëndrueshme dhe më të gjelbër.



Si banka më e madhe në Kosovë për segmentin e NMVM-ve, jemi përfshirë në financim të gjelbër për më shumë se 18 vite, qysh nga viti 2006, dhe jemi shndërruar në pararendës që ta dërgojmë vendin në drejtim të rritjes së qëndrueshme dhe më të gjelbër.

Sot, banka ProCredit parasheh ambicien për ta përqafuar Menaxhimin Social dhe Mjedisor (MSM) dhe për të përshpejtuar masat e financimit të gjelbër, si përgjigje ndaj ndryshimeve të shtuara klimatike dhe degradimit të mjedisit, të kombinuara me planet e dekarbonizimit dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

Në anën tjetër, rruga drejt tranzicionit të energjisë dhe rritja e qëndrueshmërisë janë mjaft komplekse dhe s'mund të bëhen vetëm. Kërkojnë partneritet strategjik dhe zotim të të gjithë akterëve, duke filluar nga qeveria. Të gjithë po presim me padurim të kemi strategjinë energjetike të vendit, si një plan orientues për të nxitur tranzicionin energjetik të vendit, i shoqëruar nga procese të thjeshta dhe transparente që do ta lehtësojnë zbatimin e projekteve. Investitorët dhe klientët s'do të duhej të dekurajohen për shkak të pengesave byrokratike dhe joefikase gjatë procesit. Do të duhej të hiqet sistemi i tarifave nxitëse dhe të instalohej një sistem i përzgjedhjes përmes ofertuesve/ankandeve, konkurrent, që bazohet në treg, i cili do ta zavendësonte subvencionimin e çmimeve të energjisë së karburanteve fosile, etj.

Më pas, mbikëqyrësit dhe rregullatorët bankarë duhet të marrin të dhënat, të kenë transparencë në dhënie e informacioneve shpjeguese dhe raportuese, të miratojnë një gjuhë të përbashkët komunikimi, etj.

Cila është qasja e bankës ProCredit ndaj financimit të gjelbër dhe çka na dallon nga të tjerët?

Të gjitha principet tona, pra të bankës ProCredit udhëhiqen nga parimet drejt një mjedisi më të gjelbër dhe më të qëndrueshëm. Piknisja jonë, ndryshe nga institucionet e tjera financiare, është përvetësimi i kornizës bazë nga institucioni ynë, e që është miqësor ndaj mjedisit. Kjo fillon me ne, me synimin për të minimizuar ndikimin tonë negativ në mjedis në veprimet tona të përditshme, për të promovuar proaktivisht një mënyrë të qëndrueshme të të bërit biznes si pjesë integrale e identitetit dhe strategjisë së biznesit të institucionit tonë. Për ta arritur këtë, ne kemi zhvilluar dhe zbatuar një sistem gjithëpërfshirës të menaxhimit mjedisor (EMS) që bazohet në tre shtylla:

SHTYLLA 1. Menaxhimi i brendshëm mjedisor, i përbërë nga procese dhe procedura që na ndihmojnë që sistematikisht të reduktojmë ndikimin tonë të drejtpërdrejt ndaj mjedisit.

SHTYLLA 2. Menaxhimi i rrezikut mjedisor dhe social gjatë kredithënies. Kjo shtyllë synon të na ndihmojë në zbutjen e rreziqeve mjedisore dhe sociale të klientëve tanë dhe të investimeve të financuara.

SHTYLLA 3. Kreditimi i gjelbër. Përfaqëson ambicien tonë për të pasur një ndikim pozitiv mjedisor në Kosovë duke promovuar investimet e gjelbra. Fokusi i këtij shkrimi është pikërisht që të hedh një vështrim dhe të elaborojë pikëpamjet e kësaj shtylle.

Për ne financimi i qëndrueshëm nuk ka të bëjë vetëm me kreditë e gjelbra, por ka të bëjë me ndikimin më të gjerë mjedisor dhe social të kreditimit. Kuptimi i klientëve tanë dhe nevojave të tyre, si dhe mbështetja e tyre për të filluar tranzicionin energjetik



dhe dekarbonizimin e bizneseve të tyre, ka rëndësi të madhe për ne.

Ne, rregullisht, ofrojmë burime njerëzore për ndërgjegjësimin e klientëve përmes fushatave edukative për të adresuar thellësisht të kuptuarit e duhur për çështjet komplekse rreth investimeve të qëndrueshme dhe të gjelbra. Ne i ndihmojmë klientët të eksplorojnë përfitimet e tranzicionit të energjisë, të kuptojnë teknologjitë dhe investimet që duhet të ndërrojmë, rreth fleksibilitetit të energjisë, në mënyrë që të arrijnë struktura efikase të shpenzimeve për afat të gjatë.

Në terma financiarë, kredidhënia e gjelbër është në rritje dhe përbën gati 17% të portofoliit tonë të gjithmbarshëm kreditor, deri në mars 2022; ne synojmë ta tejkalojmë 20% deri në fund të vitit 2022. Kreditë e gjelbra ndahen në tri kategori kryesore:

- Kredi për efikasitetin të energjisë si për klientët e NVM-ve ashtu edhe për klientët e amvisërive (80% e kredive tona të gjelbra deri në mars 2022). Kjo përfaqëson pjesën më të madhe të kredive tona të gjelbra të cilat inkurajojnë investimet në efikasitetin të energjisë si për NVM-të ashtu edhe për amvisëri, duke rritur kursimet, përdorimin të efektshëm si dhe zvogëlimin e faturave të energjisë elektrike.



Në terma financiarë, kredidhënia e gjelbër është në rritje dhe përbën gati 17% të portofoliit tonë të gjithmbarshëm kreditor, deri në mars 2022; ne synojmë ta tejkalojmë 20% deri në fund të vitit 2022.

- Kreditë për energjinë e ripërtrishme. Potenciali më i madh për energji të ripërtrishme në Kosovë është në energjinë diellore dhe energji të gjeneruar nga era. Padyshim, kjo paraqet të ardhmen e një 'miksi' energjetik për Kosovën dhe diskutimi mund të jetë vetëm sa shpejt mund ta shfrytëzojë vendi këtë potencial. Përvoja kryesore e bankës ProCredit deri më tani ka qenë financimi i projekteve të energjisë diellore. Kosova gëzon rrezatim diellor relativisht të lartë, ndërmjet 1200 dhe 1500 kWh/m², që përkthehet në prodhim të konsiderueshëm të energjisë elektrike nga panelet diellore. Banka ProCredit, është fuqishëm e fokusuar në shfrytëzimin e këtij potenciali dhe ka mbështetur financimin e investimeve në instalimet e paneleve diellore në dy dimensione:

A) Financim në shkallë më të vogël

Fokusi ynë për NVM-të është ti mbështesim investimet në panele fotovoltaike të decentralizuara në shkallë të vogël që mbulojnë çatitë e ambienteve të biznesit për vetëkonsumim. Ne pothuajse kemi dyfishuar numrin dhe volumnin e projekteve në PV në 2021 dhe kemi ambicie ta rrisim edhe më tej gjatë vitit 2022. Këto projekte i shohim si hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të "miksit" të energjisë, klientëve më të qëndrueshëm dhe një të ardhmeje më të gjelbër.

B) Financim i projekteve në shkallë të lartë

Kjo është formë më pak e zhvilluar e investimit dhe financimit në vend, për një sërë arsyesh. Derisa mungesa e një kornize të qartë ligjore dhe barrierat e tjera administrative i bëjnë investimet mjaft të vështira, sektorit bankar në përgjithësi i mungon ekspertiza në vlerësimin e investimeve në energjinë e ripërtrishme përmes një metodologjie financimi projektesh. Ndryshe nga kjo situatë, ProCredit ka investuar në ngritjen e kuadrove të trajnuara brenda bankës, për t'u angazhuar dhe për të vlerësuar projektet e financimit të projekteve të energjisë së ripërtrishme.

Në qendër të kësaj metodologjie është vendimi bazuar në qëndrueshmëri të rrjedhës së parasë në të ardhmen, dhe jo sikur në të kaluarën, siç ishte qasja tradicionale e vlerësimit të financimit të NVM-ve.

Megjithatë, qasjes së re të financimit të projektit, sigurisht që nuk i mungojnë rreziqet, veçanërisht në një treg pa përvojë. Prandaj, ekuilibri midis projekteve pa burime të ardhurash dhe atyre me burime të plota të ardhurash, do të bëjë ndryshimin për një përshtatje të shpejtë të teknologjisë dhe një tranzicion të shpejtë të energjisë. Por, për ta përfshirë financimin e projekteve pa burime të ardhurash, kërkohen skema garantuese ose mbulueshmëri me kolateral, për ti përmbushur standardet e kualifikimit për garanci nga banka. Kjo i jep një rëndësi të madhe çdo dritareje për garanci kreditore për ER nga FKGK, si një mundësi e rëndësishme në sistemin financiar.

- Investime të tjera të menaxhimit mjedisor, si alternativat e riciklimit, menaxhimi i mbeturinave, bujqësia e qëndrueshme etj.

Është e rëndësishme të theksohet se pjesë e përpjekjeve të grupit ProCredit për të vlerësuar rrezikun klimatik dhe për të kufizuar ndikimin tonë në ndryshimet klimatike, jemi angazhuar për të matur dhe zbuluar emetimet e gazrave serrë, të lidhura me portofolin tonë të kredisë dhe investimet, në përputhje me standardet financiare të llogaridhënies për emetim karboni.

Ju ftoj që të lexoni raportin e grupit tonë Raporti i ndikimit 2021. Nëse e konvertojmë në ndikimin që bën në ambient, ulja e CO₂ nga portfoli ynë i kredisë së gjelbër është 638,545 tCO₂ eq.

Në fund të fundit, për ne, nuk mjafton të tregojmë sa kredi të gjelbra kemi financuar, por është më e rëndësishme të bëjmë matje dhe të zbulojmë reduktimin e emetimeve të CO₂ dhe ndikimin real që kjo ka në mjedis.

Çfarë ishte rrugëtimi ynë drejt financave të qëndrueshme dhe kreditimit të gjelbër, çfarë na bën të suksesshëm?

Faktori kyç kanë qenë vitet e përkushtimit dhe investimeve të vazhdueshme në kapacitetet e brendshme dhe përvetësimi i parimeve dhe qasjes sonë. Ambicia për financim të qëndrueshëm dhe më të gjelbër nuk është qasje afatshkurtër. Ka filluar me vizionin dhe vendosmërinë e aksionerëve dhe menaxherëve për të adoptuar parimet e gjelbra dhe për të ndërmarrë veprime konkrete. Krijimi i kuadrove të menaxhimit mjedisor dhe social, kërkon njohuri dhe ekspertizë solide në lidhje me aspektet teknike dhe ligjore të projektit; kërkon investime në aftësitë e modelimit financiar/ financimit të projekteve dhe zhvillimin e teknikave të përshtatshme të menaxhimit të rrezikut të kredisë. Trajnimet e rregullta të stafit në bankë, përmes Akademisë të ProCredit dhe përmes shkëmbimit të rregullt të përvojave me banka të tjera të grupit ProCredit, kanë qenë shumë të rëndësishme për një sukses të qëndrueshëm.

Raporti ynë i ndikimit të grupit 2021 përfaqëson leadershipin tonë, vazhdueshmërinë tonë në financim të qëndrueshëm dhe bankim të përgjegjshëm, përparimin tonë në reduktimin e emetimeve të karbonit dhe përshtetimin e huadhënies së gjelbër, duke e ilustruar me matrica/ forma transparente. Përderisa, mjedisi i përkeqësuar dhe ndryshimet klimatike përbëjnë një sfidë të vazhdueshme për ne, brezit tonë i mbetet të veprojmë me urgjencë. Banka ProCredit është e përkushtuar ta ndjekë këtë rrugëtim. Çështje thelbësore është bashkimi i forcave me FKGK-në dhe të gjitha palët e tjera të interesuara, për të nxjerrë gjithë potencialin e tregut dhe për të mbështetur rrjedhën e kapitalit drejt klientëve dhe investimeve të gjelbra në Kosovë. Ne synojmë të qëndrojmë në ballë të kësaj përpjekjeje globale dhe lokale, duke konfirmuar se kjo është pjesë e asaj që jemi: një bankë e përgjegjshme, etike, e qëndrueshme për të cilën kanë rëndësi parimet, mjedisi dhe shoqëria.



TË ARRITURAT DERI MË 31 MARS 2022

17,579

VENDE TË REJA PUNE

1,231



Bujqësi, pylltari
dhe peshkatari

3,530



Prodhim

6,013



Tregti me
shumicë e pakicë

1,871



Ndërtimtari


4,934



Shërbime

KREDI PËR GRATË NË BIZNES

12.5% e kredive të garantuara
janë për gratë ndërmarrëse




12.5%



*Parashikim i raportuar nga përfituesi si rezultat i investimit të bërë përmes kredisë së garantuar!

TË ARRITURAT E FKGK-së DERI MË 31 MARS 2022



ENERGJIA EFIÇIENTE SI NJË DOMOSDOSHMËRI NË KOSOVË

“Është vështirë të parashikojmë të ardhmen por mund të jemi të sigurtë që sektori i energjisë, pas njëzet vitesh, do të duket shumë më ndryshe se sot. Edhe pse do të vazhdohet me prodhimin e energjisë nga fosilet, energjia e ripërtëritshme pritet të përbëjë deri 70% të tërë energjisë së prodhuar ndërsa emetimi i karbonit pritet të zvogëlohet për 80%. Kërkesa e përgjithshme për energji parashikohet të rritet për 28% në njëzet vitet e ardhshme por ajri do të jetë më i pastër e planeti jonë më i shëndetshëm¹”.

Energjia është një sektor strategjik për çdo vend prandaj meriton që ti jepet një vëmendje e veçantë. Si një nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik, energjia ka ndikim të drejtëpërdrejt në ngritjen e nivelit të jetesës. Por ngritja e standardit të jetesës në të njëjtën kohë shoqërohet edhe me ngritjen e kërkesës për energji, kjo sjell sfida të reja si prodhimi i energjisë sa më të pastër dhe shfrytëzimi racional i saj. Mundësitë e furnizimit me energji elektrike në Kosovë janë tejet të limituara për shkak të termoelektraneve të vjetëruara dhe burimeve të ripërtëritshme të kufizuara. Kosova si një shtet i ri, që nga lufta, u përball me një infrastrukturë energjike të shkatërruar e në të cilën nuk kishte investime të reja që nga vitet e tetëdhjeta.

Në këtë situatë është e pamundur të mendohet plotësimi i kërkesës së rritur për energji pa përmirësimin e efikasitetit të energjisë. Për Kosovën efikasiteti i energjisë mund të konsiderohet edhe si burim energjie, ashtu si e konsideron edhe Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë (IEA) “karburanti i parë në botë” sepse do të mundësonte që me shfrytëzim më racional të energjisë së prodhuar të rritet energjia e disponueshme dhe të zvogëlohet varësia nga importi.



BAHRIJE DIBRA

Koordinatorë e lartë për sektorin e financave dhe energjisë - KfW

Vendet e Ballkanit Perëndimor, edhe Kosova, sipas IEA, karakterizohen me intensitet të lartë të energjisë që është tri herë më i lartë se mesatarja në vendet e EU, kjo e bën energjinë efiçente një domosdoshmëri, gjë që tregon se potenciali për kursim të energjisë është i jashtëzakonshëm.

Energjia efiçente po merr gjithnjë e më shumë vëmendjen në tërë botën. Kombet e Bashkuara (UN) kanë filluar iniciativën “Energji të qëndrueshme për të gjithë”(SE4All) me qëllim të dyfishimit të normës globale të efikasitetit të energjisë deri më 2030 dhe arritjes së Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm 7 (SDG7) që bën thirrje për “energji të përballueshme, të besueshme, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë”

¹ https://new.ingwb.com/binaries/content/assets/insights/research-wt_mc=ING_WB_BI_intext

Por, çka kuptojmë me energji eficiente?

Efikasiteti i energjisë do të thotë: më pak përdorim i energjisë, për të kryer të njëjtën detyrë ose të jep të njëjtin rezultat. Shtëpitë dhe ndërtesat me energji të efektshme përdorin më pak energji për ngrohje, ftohje, për pajisje elektronike, dhe kompanitë prodhuese me efektshmëri energjike përdorin më pak energji për të prodhuar mallra. Energjia efiçiente është mënyra më e lehtë për ta luftuar ngrohjen globale, zvogëlimin e shpenzimeve për energji të konsumatorët dhe ngritja e konkurrencës në bizneset.



Vendet e Ballkanit Perëndimor, edhe Kosova, sipas IEA, karakterizohen me intensitet të lartë të energjisë që është tri herë më i lartë se mesatarja në vendet e EU, kjo e bënë energjinë efiçiente një domosdoshmëri, gjë që tregon se potenciali për kursim të energjisë është i jashtëzakonshëm.

Eficientia e energjisë, na mundëson furnizim më stabil me energji sepse kursimi i energjisë do të reduktoj ngarkesën e rrjetit që do të pakësoj ndërprerjet që shkaktohen nga mbingarkimet në rrjetin e shpërndarjes.

Eficientia e energjisë na mundëson si konsumatorë, të kursejmë para sepse investimet në masat e energjisë efiçiente do të reduktojnë shpenzimet e energjisë e me to edhe faturat tona. Zvogëlimi i përdorimit të energjisë mundëson uljen



Eficientia e energjisë, na mundëson furnizim më stabil me energji sepse kursimi i energjisë do të reduktojë ngarkesën e rrjetit që do të pakësoj ndërprerjet që shkaktohen nga mbingarkimet në rrjetin e shpërndarjes.

e faturave të energjisë e kjo e bënë më të përballueshme për familjet dhe bizneset. Produktet efiçiente kanë kosto më të lartë, por përdorimi i tyre, mundëson që të kursejmë në afat më të gjatë.

Nga efiçienca e energjisë, si komunitet do të kemi ambient më të mirë për shëndet më të mirë; sepse me reduktimin e energjisë së shpenzuar do të kontribuojmë edhe në zvogëlimin e ndotjes së ajrit që vjen nga prodhimi i energjisë nga fosilet. Zvogëlimi i emetimit të gazrave serë që vjen nga prodhimi i energjisë nga fosilet (si thëngjilli në rastin e Kosovës) do të rezultoj me ajër, ujë e tokë më të pastër të cilat ndikojnë drejtëpërdrejt në shëndetin e popullësisë.

Kudo që përdoret enegjia ka mundësi të përmirësimit të efikasitetit të shfrytëzimit të saj. Produktet që shfrytëzojnë direkt energjinë, mund ta zvogëlojmë energjinë e shfrytëzuar, përmes përdorimit të pajisjeve ekonomike/efiçiente, ndërsa te produktet tjetra që nuk e shfrytëzojnë direkt enegjinë por që rrisin efikasitetin e shfrytëzimit të kësaj energjike duke rritur edhe komoditetin e një ndërtese/shtëpie si për shembull izolimi termal apo dritaret efiçiente.

Në Kosovë, ngrohja e ndërtesave përbën rreth 70% të energjisë termale të shpenzuar. Shumica e ndërtesave publike e private kanë izolim të dobët dhe kjo shkakton harxhim të lartë energjike

për ti arritur temperaturat në nivelin e kërkuar në shkolla apo spitale. Shumica e ndërtesave publike në Kosovë kanë nevojë për renovim që përfshin përmirësimin e izolimit të ndërtesës, ndërrimin e dritareve, kalimin në ngrohje/ftohje eficiente dhe masa tjera për efikasitet të energjisë, që do të zvogëlonin konsumin e energjisë në to.

Në Kosovë, mundësitë e investimeve në efikasitet të energjisë janë të kufizuara, si për shkak të çmimit të ulët të enegjisë, deri tani, por edhe për shkak se konsiderohen jo atraktive. Bankat komerciale kanë zhvilluar kredi që targëtojnë pikërisht efikasitetin e energjisë, por investimet afatgjata ende nuk janë në nivelin e dëshiruar. Mungesa e kapitalit dhe kreditimit afatgjat për efikasitet të energjisë, konsiderohet si pengesë për NMVM-të që të rrisin investimet në këtë lëmi dhe të shfytëzojnë potencialin e madh që ekziston në vend, për kursim të enegjisë nga NMVM-të.

Natyrisht si kompani të vogla, NMVM-të shpenzojnë pak energji por duke llogaritur që ato bëjnë mbi 90% të kompanive sipas IEA, përbëjnë rreth 13% të kërkesës për energji dhe me masat e energjisë eficiente, do të mund të zvogëlonin shpenzimet e tyre deri 30%. Me zvogëlimin e shpenzimeve përmes implementimit të masave të energjisë eficiente, NMVM-të do të rrisnin profitin dhe

konkurrueshmërinë. Kjo do të kontribonte në rritjen e punësimit, zgjerimin e tregut, reduktimin e ndotjes së ajrit dhe do të mundësonte investime të reja. Por, përkundër përfitimeve të shumta, NMVM-të nuk janë shembull i implementimit të masave të energjisë eficiente. Arsyet janë të shumta si: mungesa e informatave, mungesa e ndërgjegjësimit për përfitimet nga këto kursime; mungesa e ekspertizës teknike; si dhe vështirësitë e qasjes në financim.

Por, studimet tregojnë se investimet në masat e energjisë eficiente, mundësojnë kursime energjie që kanë ndikim të drejtëpërdrejtë në përfitimet e NMVM-ve dhe mundësojnë fitime në afatgjata. Ashtu si ka thënë Jeff Goodell "në realitet, studimet tregojnë se investimet për të nxitur energjinë e ripërtëritshme dhe për të rritur efikasitetin e energjisë gjenerojnë shumë më tepër punë sesa nafta dhe qymyri"²


Në fund, do të ishte e dobishme që të përgaditen programe përmes të cilave ndihmohen NMVM-të, që të kuptojnë potencialin e tyre në energji eficiente, ndërsa institucionet financiare të zhvillojnë linja kreditore afatgjata të dedikuara energjisë eficiente si dhe të ofrojnë mundësi lizingu për pajisje që janë eficiente.




2 Jeff Goodell është një autor amerikan dhe redaktor kontribues në revistën Rolling Stone. [1] Shkrimet e Goodell janë të njohura për një fokus në çështjet e energjisë dhe mjedisit.



KREDITË E MIRATUARA



KREDITË SIPAS SEKTORËVE



RRITJA E QARKULLIMIT

Deri më 31 mars 2022

10,743
kredi për NMVM-të



529.4 milionë euro

apo mbi 11% rritje të qarkullimit mbi bazën e tanishme të qarkullimit të NMVM-ve përkatëse



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

VLERËSIMI I POTENCIALIT TË KULMEVE PËR SOLARE NË KOSOVË

Drejtimi i gjelbër është më shumë se sa një trend, është një tranzicion i energjisë, i klimës si dhe atij ekonomik në gjithë botën ashtu edhe në Kosovë. Një komponent kyç i agjendës së gjelbër dhe dekarbonizimit është edhe energjia e ripërtëritshme, përfshirë këtu dhe energjinë solare fotovoltaike me kapacitetit të vogël.

Për të kontribuar në përshpejtimin e aplikimit të energjisë solare, Agjencia për ZhvillimNdërkombëtar e Shteteve të Bashkuara (USAID) në bashkëpunim me ekspertë vendor po identifikojnë mundësitë, përmes analizave gjeohapsinore të realizuara me dron, që bizneset në Kosovë të shqyrtojnë sistemet fotovoltaike mbi kulm.

Vlerësimi i potencialit të energjisë solare për bizneset është dizajnuar të përcaktojë sasinë e energjisë elektrike që mund gjenerohet nga secili kulm në mënyrë që të rrisë kërkesën për instalimin e sistemeve fotovoltaike si burim të pastër i energjisë.



Ky vlerësim është kryer për 300 biznese të cilat operojnë në shtatë zona industriale ku furnizimi me energji elektrike është sfidues ndërsa kërkesa për energji elektrike është në rritje. Që në hapin e parë të procesit, në zonat e përzgjedhura është kryer incizimit topografik nga ajri përmes fotografimit me dron.





Drejtimi i gjelbër është më shumë se sa një trend, është një tranzicion i energjisë, i klimës si dhe atij ekonomik në gjithë botën ashtu edhe në Kosovë. Një komponent kyç i agjendës së gjelbër dhe dekarbonizimit është edhe energjia e ripërtëritshme, përfshirë këtu dhe energjinë solare fotovoltaike me kapacitetit të vogël.

Nga të dhënat e fituara janë krijuar modelet digjitale të sipërfaqes (DSM) me paraqitjen 3D të objekteve. Me procesimin e mëtutjeshëm gjeo-hapësinor në GIS është përcaktuar rrezatimi solar që

pranon secila sipërfaqe e kulmit dhe është llogaritur potenciali i kulmeve për të prodhuar energji elektrike. Krahas këtyre shtatë zonave, të njejtat matje mund të bëhen shumë lehtë në të gjitha qytetet, rajonet apo edhe në shtete tjera. Në fazën tjetër është realizuar studimi i fisibilitetit i sistemeve solare krahas një sërë analizave që kanë të bëjnë me kushtet në treg si: çmimi i energjisë elektrike, çmimi i instalimit, normat e interesit në banka, e të tjera. USAID-i deri më sot ka mbështetur mbi 70 studime fizibiliteti. Pastaj, bizneseve i është prezantuar analiza e tregut që përmban udhëzimet që të bëhet gjenerues për vetë-konsum si dhe i është dhënë mbështetje joformale në proceset administrative, mundësitë e financimit, si dhe i është ofruar lista e instaluesve profesional të sistemeve solare.

Përmes iniciativave inovative sikur kjo e vlerësimit të potencialit të kulmeve për prodhimin e energjisë nga dielli, USAID-i po ndihmon në promovimin e qasjes miqësore ndaj klimës, gjenerim të qëndrueshëm të energjisë elektrike për bizneset në Kosovë. Njëkohësisht po ndihmon në vetëdijësimin për rëndësinë e kursimit të energjisë, furnizimit të qëndrueshëm me energji dhe mundësitë e instalimit të sistemeve solare.

PRIORITY ZONES

1. Peja Industrial Zone
2. Prishtina – Ferizaj
3. Drenas Business Park
4. Gjilan Industrial Zone
5. Prizren Business Zone
6. Suhareka Business Park
7. Gjakova Industrial Zone



The United States Agency for International Development (USAID) is one of the world's premier international development agencies and a catalytic actor driving development results in Kosovo and beyond."

METAL IN PANELET SOLARE – INVESTIM I MENÇUR

Përpunimi i metaleve është industri e vështirë, këtë e përjetuam në një punishte me mbi 25 punëtorë, me shumë makina për përpunimin e hekurit dhe shndërrimin në tela metalike, të gatshme për nevoja të tregut. Një biznes që fillet i ka që nga viti 2011 ka arritur që produktet e veta ti plasojë jo vetëm në tregun vendor por edhe më gjerë, pra në vende të rajonit dhe Evropë.

Pronari i këtij biznesi, z. Nexhmi Lahu, njohës i mirë i industrisë, me përvojë të gjatë në Fabrikën e Armaturës Ndërtimore (FAN) që u privatizua në vitin 2006, na shpjegoi fillësën e kësaj punëtore si dhe sfidat e shumta me të cilat përballet kjo industri.

Duke e vizituar vendpunishten nga pika e parë e pranimit të materialit për përpunim, tutje nëpër pikat e gjithë procesit hap pas hapi, krijuam përshtypjen se sa i rëndësishëm dhe njëherit edhe i vështirë është gjithë ky proces i punës. Kërkohej koncentrim gjatë gjithë kohës, sepse puna me metal është e vështirë dhe e rrezikshme njëkohësisht. Zhurma e madhe e makinave të punës, hapësira e gjerë, të jepnin ndjesinë e prodhimit dhe fabrikës së vërtetë.

“Për mua, zhurma e makinave është muzika e mëngjesit, nëse nuk ndëgjohej kjo muzikë në mëngjes do të thotë kemi ndonjë problem dhe prodhimi nuk ka filluar” – tha z. Lahu derisa e vizituam në fabrikë, në zyren e tij.

Si proces, për të arritur deri në produktin final, janë disa hapa që secila makinë duhet ta përcjellë dhe proceson dhe të cilat shpenzojnë shumë energji elektrike. *“Ky shpenzim sigurisht që rrit koston e prodhimit dhe janë pikërisht panelet solare zgjidhje e duhur për këtë lloj prodhimitarë. Prandaj jemi interesuar që ta konsiderojmë si investim që do të ketë ndikim afatgjatë.” – na tha z. Lahu.*

METAL IN ka shfrytëzuar kredinë për investim në panelet solare, meqë kjo industri është shpenzuese e madhe e energjisë elektrike. Prandaj, panelet solare konsiderohen investim i mençur, i cili në një periudhë gjashtë deri në shtatë vjeçare, do ti kthejë investimet.

Me këtë investim, Metal In do ti reduktojë shpenzimet e faturës së energjisë elektrike deri në 50% dhe do të shmang lirim të rreth 300 ton dioksid karboni (CO₂) në vit. Gjë që do të kontribuojë pozitivisht në ruajtjen e mjedisit.


Z. Lahu gjithashtu, është duke konsideruar mundësinë e shtimit të kapacitetit të panelave solare në mënyrë që të zvogëlohen edhe më shumë shpenzimet e energjisë elektrike. *“Natyrish, ky investim parashihet të bëhet në të ardhmen pasi të ndërtohet objekti shtesë. Por, jemi në pritje të ndryshimit të rregullativës ligjore që na mundëson shitjen e energjisë elektrike në treg, që deri tani mungon”.*






Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, sipas Shoqatës Evropiane për Institucione Garantuese (AECM), gjatë vitit 2021 ka qenë ndër institucionet garantuese me rritjen më të madhe në Evropë.

I. Në vitin 2021, mbulueshmëria e NMVM-ve aktive nga skemat garantuese të FKGK-së ka arritur në 14.6%



II. Portfolio aktive e garancive kreditore si përqindje e GDP-së ka patur rritje 100% nga 0.8% sa ishte në 2020, në 1.6 % që është mbi mesataren e vendeve të Evropës dhe ka kaluar skemat garantuese të shteteve të Ballkanit Perëndimor, përkundër faktit se shumica e këtyre shteteve kanë institucione garantuese shumë më gjatë se Kosova.



NËNSHKRIMI I MARRËVESHJEVE

FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE NËNSHKRUAN MARRËVESHJE ME AFK

9 mars 2022 - Në ambientet e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), u nënshkrua Marrëveshja e Garancisë me Agjencionin për Financim në Kosovë (AFK), për garantimin e kredive bujqësore brenda Dritares Agro të FKGK-së. Kjo ngjarje shënon më tutje zgjerimin e marrëveshjeve që FKGK realizon me Institucionet Mikrofinanciare duke ofruar garanci për kredi bujqësore për fermerët dhe agrobizneset vendore.

Dritarja Agro është skemë garantuese që operon në kuadër të FKGK-së me qëllim të mbështetjes së fermerëve dhe agrobizneseve duke garantuar kredite për këtë sektor. Deri më tani janë garantuar rreth 33.6 milion euro - kredi bujqësore dhe janë rreth 11.4 milion euro garanci aktive në këtë sektor. Kapitali i përgjithshëm i Dritares Agro është në vlerë totale prej 11.5 milion euro që është financuar plotësisht nga Qeveria Gjermane, përmes Bankës Gjermane për Zhvillim – KfW.



AKTIVITETET E FKGK-së


TË ARRITURAT NGA PAKO E RIMËKËMBJES EKONOMIKE






ZHVILLIMI I PORTFOLIOS SË DRITAREVE NË KUADËR TË PAKOS SË RIMËKËMBJES EKONOMIKE

ZHVILLIMI I PRE-së



ZHVILLIMI I PORTFOLIOS SIPAS SECILËS DRITARE

DRITARET E PRE-së



Shuma e kredisë
Shuma e garancisë
Numri

Shuma e kredisë	105,555,705	11,736,215	6,971,200	28,719,074	25,453,740	31,840,876	834,600
Shuma e garancisë	74,948,973	8,592,222	5,226,910	19,943,859	17,956,255	22,572,077	657,650
Numri	2,015	269	152	394	593	572	35

MBAHET TRYEZA VIRTUALE - "PAKOJA E RIMËKËMBJES EKONOMIKE - REZULTATI DHE IMPAKTI"

26 janar 2022 - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), organizoi tryezë virtuale "PAKOJA E RIMËKËMBJES EKONOMIKE REZULTATI dhe IMPAKTI" me ç'rast u prezantuan rezultatet e Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike si dhe të arriturat e FKGK-së gjatë vitit 2021.



FKGK MBAN PUNËTORINË "AGRO WORKSHOP"

15 mars 2022 - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore mbajti punëtorinë "Agro Workshop" për banka dhe institucione mikrofinanciare partnere! Në këtë trajnim morën pjesë institucionet e regjistruara financiare. temat e trajnimit ishin: Zhvillimet në garantimin e agro kredive; Rritja/Rënia neto në agro portofolin e IF; Pjesëmarrja e Agro garantimit në Agro financim; Financimi i fermerëve me NIF (participim sipas shumave); NPL në agro sektor; Claim-at e paguar; Garantimi i agro granteve.



FKGK LANSON FUSHATËN DHE VIDEOON PËR START UP-ËT

22 mars 2022 – Lansohet fushata dhe video për StartUP - FKGK përkrahë idetë e reja dhe ndërmarrësinë! Fondi Kosovar për Garanci Kreditore përmes institucioneve financiare partnere, ofron bashkëpunim dhe mbështetje për bizneset StartUp.



FKGK MBAN LIGJERATËN ME TITULL "ROLI I SKEMAVE GARANTUESE" NË RIT KOSOVO

29 mars 2022 - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore mban ligjeratën me titull "Roli i skemave garantuese" në RIT Kosovo, në klasën e profesor Fadil Sahiti. Kjo ligjeratë u organizua për studentët e degës menaxhment dhe biznes, me qëllim të njohjes me punën, kontributin, rezultatet, funksionin e FKGK dhe skemave garantuese në përgjithësi.



FKGK MBAN LIGJERATËN ME TITULL "ROLI I SKEMAVE GARANTUESE" NË KOLEGJIN RIINVEST

8 prill 2022 - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore mban ligjeratën me titull "Roli i skemave garantuese" në klasën e profesor Gëzim Turkeshi në kolegjin Riinvest. Kjo ligjeratë u organizua për studentët e degës menaxhment dhe biznes, me qëllim të njohjes me punën, kontributin, rezultatet, funksionin e FKGK dhe skemave garantuese në përgjithësi.



FKGK MBAN TRAJNIM ME STAFIN E AFK-së

7 prill 2022 – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore mbajti trajnim me stafin e AFK – Agjencioni për Financim në Kosovë. Në fokus të trajnimit ishin roli i FKGK-së dhe Dritares Agro në veçanti, duke ju ofruar mundësinë e një përfshirje sa më të madhe për financimin e fermerëve vendorë. Ndër të tjera, stafi i AFK-së, u trajnua edhe për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor dhe Social.



FKGK NË PUNËTORINË “KEY ACCOUNT MANAGEMENT” TË ORGANIZUAR NGA OEGJK

21 prill 2022 – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore në punëtorinë “Key Account Management” të organizuar nga OEGJK, trajnim që u mbajt nga z. Kastriot Këpuska, Agro Expert nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore. Punëtorja “Key Account Management” është një hap i rëndësishëm në rrugën drejt diferencimit, optimizimit të rezultateve të biznesit dhe rritjes së sigurt të të ardhurave. Gjatë kësaj punëtorie u diskutuan tema të ndryshme si: Bashkëpunimi me institucionet financiare (bankat dhe MFI), procesi Due Diligence, sinkronizimi i objektivave, procesi i ndarjes së limiteve, negociimi i kontratave me këto institucione financiare, rëndësia e relacionit formal dhe joformal për komunikim sa më efektiv. Trajnimi i stafit të këtyre institucioneve partnere, transmetimi i kushteve dhe kërkesave të donatorëve të institucionet partnere; Pranimi dhe diskutimi i rasteve të garantuara; Kërkesat për produkte të reja, etj

Workshop!

**Key Account
Management**



FKGK MBAN LIGJERATËN “ROLI I SKEMAVE GARANTUESE” NË UBT

22 prill 2022 – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore gjatë ligjeratës së mbajtur me titull “Roli i skemave garantuese” në klasën e profesor Shpresim Vranovci në Institucionin e edukimit të lartë – UBT. Kjo ligjeratë u organizua për studentët e degës menaxhment dhe biznes, me qëllim të njohjes me punën, kontributin, rezultatet, funksionin e FKGK dhe skemave garantuese në përgjithësi.



FKGK MBAN LIGJERATËN “ROLI I SKEMAVE GARANTUESE” NË AAB

22 prill 2022 – Në kuadër të Javës Botërore të Kreativitetit dhe Inovacionit, FKGK mbajti ligjeratë për studentët e Fakultetit Ekonomik. Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) mbajti ligjeratë në Kolegjin AAB me temën “Roli i skemave garantuese”. Ligjeratën për studentë e zhvilloi z. Alban Kastrati, Menaxher i Lartë i Riskut. Ai shpalosi rolin e FKGK në financimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) në ekonominë e Kosovës, sidomos në ata sektorë që bankat komerciale hezitojnë të ndërmarrin rrezik financiar, si në bujqësi, startaup-e, kredi për biznese të grave, kredi për ekonomi të gjelbër etj.





FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

Buletin i FKGK-së

EDICIONI I KATËRT | Maj 2022

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

Adresa:
Njazi Alishani Nr. 5,
10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 (0) 38 225 600
info@fondikgk.org

www.fondikgk.org